



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria e Arsimit
Nr.07-Zyrtarisht
17.03.2021

Në bazë të nenit 64, paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Deçan, shpallë këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vend i Lirë /Me kohë të caktuar / Zëvendësim	Numri i pozitave
1	Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Jusuf Gërvalla" Prapaqan	Mësues Klase	Vend i Lirë	1
2	Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Jusuf Gërvalla" Prapaqan, paralelja në Dubovik	Mësues Klase	Kohë të Caktuar	1
3	Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Ardhmëria" Beleg	Mësues Klase	Kohë të Caktuar (Mandati i Drejtorit të Shkollës)	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit;
- Rezymja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta - kopje);
- Diploma e kualifikimit të noterizuar;
- Trajnime (nëse ka);
- Vërtetimin për përvojën e punës (nëse ka);
- Certifikata që nuk jeni nën hetim;
- Certifikata e lindjes;
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomën e nostrifikuar në MASHT.


II. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Për listë të ngushtë do të ftohën vetëm kandidatët, të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura, në mungesë kualifikimi i përafërt.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje, (kualifikimet universitare duhet të jenë të noterizuara), dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkojnë me rastin e intervistës.

Formularin i Aplikimit për Punësime shkarko këtu: <https://kk.rks-gov.net/decan/sherbimet/formulare/>.



Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në faqen zyrtare të komunës, duke filluar nga data e publikimit më: **17.03.2021** më datën: **31.03.2021**.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes zyrës së DKA-së Nr. 52 , në objektin e Komunës së Deçanit.

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, do të zëvendësohet në vartësi të lirimit real të vendit të punës.

